



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
Klinë, dt: 11.03.2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare nr.28, më datën 04.06.2008, dispozitat e nenit 8 të Rregullores së MF-së nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-123/2010 të datës 04.04.2010 si dhe duke marrë parasysh Thirrjen për financim të OJQ-ve të datës 21.02.2024, Kryetari i Komunës së Klinës, më datë 11.03.2024 mori këtë;


V E N D I M

Për formimin e komisionit vlerësues të aplikacioneve nga OJQ-të për financim publik

1. **Formohet** komisioni komunal për vlerësimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e përfitueseve sipas Thirrjes Publike 10Nr451-5371/24, të datës 21.02.2024, për financim publik të OJQ-ve.

Komisioni përbëhet nga anëtarët:

1. Rexhë Buqani - Drejtorja për kulturë, rini dhe sport
2. Katarina Mrijaj - Drejtorja për kulturë, rini dhe sport
3. Blerina Hoti - Drejtorja e financave dhe zhvillimit ekonomik
4. Vlera Morina - OJQ
5. Ariana Berisha - Shoqëria civile



2. **Caktohet** anëtar rezervë **Skender Merturi** i cili në rast të ndonjë konflikti interesi të anëtarëve të rregullt, do ta zëvendësojë atë në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.
3. Anëtarët e komisionit do të vlerësojnë aplikacionet në përputhje me dispozitat e rregullores së MF-së - Nr - 04/2017, në bazë të kriterëve të kërkuara në thirrjen publike mbështetur në dispozitat e nenit 10 dhe 11 të rregullores MF - Nr. 04/2017 (kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikantët).
4. Ky vendim është i plotëfuqishëm për zbatim në momentin që nënshkruhet nga kryetari i komunës.

Të njoftohen:

- Zyra e kryetarit
- DKRS
- Anëtarët e komisionit
- Zyra e informimit
- Arkivi

Kryetari i Komunës

z. Zenun Elezaj

